



PRILL 2021

NEWSLETTER



**REKTORI DEMJAHU NËNSHKROI DOKUMENTIN E RI
TË MAGNA CHARTA UNIVERSITATUM MCU2020**



**U ZHVILLUA ME SUKSES KONFERENCA SHKENCORE
NDËRKOMBËTARE “PERSPEKTIVA E INTEGRIMIT TË
BALLKANIT PERËNDIMOR NË BE”**



**NË DITËN BOTËRORE TË LIBRIT, TRI STUDENTE FITUESE
TË ÇMIMIT “MASAR STAVILECI”**



**SANA KLINIKEN AG NË GJERMANI PUNËSON STUDENTIN
E PARË NGA KOSOVA, I DIPLOMUAR NË KOLEGJIN AAB**



**STUDENTJA LIRIE HOTI FITON BURSË TË PLOTË PËR
PROGRAMIN E LIDERËVE TË INOVACIONIT QË MBAHET
NË UNIVERSITETIN E LUND NË SUEDI**

FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE NËNŠHKROI MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME FEDERATËN E BODY-BUILDING & FITNESS TË KOSOVËS

2 Prill 2021


Përmes këtij bashkëpunimi palët janë dakorduar të përcaktojnë programe të përbashkëta për realizimin e pjesës praktike të studentëve, për mbrojtjen e interesit të studentëve, për zhvillimin e njohurive të reja respektivisht atyre praktike, në kuadër të lëndës së Fitnesit.

Po ashtu palët janë marrëvesh që bashkëpunimin e tyre ta realizojnë edhe në shkëmbimin e materialeve e literaturës profesionale si dhe informacioneve të tjera të nevojshme.



Kjo marrëveshje u siguron palëve angazhimin për realizimin e programeve të veçanta akademike afatshkurtra, përfshirë organizimin e përbashkët të shkollave verore, kampeve të ndryshme, manifestimeve të ndryshme, garave të niveleve të ndryshme. Krahas këtyre edhe licenimi i studentëve për trajner personal të Fitnesit, do të jetë një nga pikat me interes të kësaj marrëveshjeje.

Marrëveshja u nënshkrua nga Dekani i Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit, Fatmir Pireva dhe Sekretari Gjeneral Federatës, Z.Sabri Dragusha.



ZËVENDËS AMBASADORI FRANCEZ NË PRISHTINË Z. FRANCOIS CYPRIEN, NDAN CERTIFIKATA PËR STUDENTËT E FAKULTETIT TË KOMUNIKIMIT MASIV

2 Prill 2021



Përfundoi me sukses trajnimi “Luftimi i lajmeve të rreme”, i organizuar nga Fakulteti i Komunikimit Masiv në kuadër të bashkëpunimit me organizatën franceze CFI.

Në ceremoninë përmbyllëse dhe në ndarjen e certifikatave për pjesëmarrësit mori pjesë edhe zëvendës ambasadori francez në Prishtinë, z. Francois Cyprien, i cili i përgëzoi pjesëmarrësit për rezultatet e arritura dhe shprehu gatishmërinë e Ambasadës Franceze për të vijuar me organizime të tilla në dobi të studentëve.

Delegacioni i Ambasadës Franceze u prit në takim nga zëvendës rektori Shemsedin Vehapi, i cili i falënderoi të pranishmit dhe shprehu interesim për të vazhduar edhe me trajnime të tjera.



Ligjërues në këtë trajnim dyditor, ishte profesoresha Ilire Zajmi e përzgjedhur nga CFI, ndërsa pjesë e trajnimit ishte edhe Robert Bourgoing, ekspert francez i komunikimit, i cili u inkuadrua në lidhje direkte nga Franca.

CFI është anëtar i Forumit Global për Zhvillimin e Mediave (GFMD), një organ i ngritur në 2004 për të koordinuar dhe lobuar në emër të atyre që punojnë për bashkëpunimin mediatik, për të koordinuar veprimet e anëtarëve të saj në shërbim të zhvillimit në vendet në pritje të ndihmës ndërkombëtare. CFI është një operator i sektorit publik i financuar kryesisht nga Ministria Franceze e Evropës dhe Punëve të Jashtme.


U SHËNUA 6 PRILLI, DITA NDËRKOMBËTARE E SPORTIT PËR ZHVILLIM DHE PAQE

7 Prill 2021

Me rastin e 6 Prillit, Ditës Ndërkombëtare të Sportit për Zhvillim dhe Paqe, organizuar nga Fakulteti i Kulturës Fizike, në Kolegjin AAB u mbajt një tryezë diskutimi ku të ftuar ishin presidenti i sapozgjedhur i Komitetit Olimpik të Kosovës, z. Ismet Krasniqi dhe z. Besim Aliti, këshilltar i presidentit të KOK.

Në hapje të tryezës, dekani i Fakultetit të Kulturës Fizike, prof.asoc.dr.Fatmir Pireva foli për kontributin pozitiv që sporti mund të ketë në realizimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe përparimin e të drejtave të njeriut.

Presidenti i KOK, Ismet Krasniqi në këtë tryezë foli për plan programin e tij si udhëheqës i këtij institucioni dhe zhvillimin e mëtejshëm të tij: “Qëllimi im kryesor është të zhvillojmë sportin në Kosovë në mënyrë strategjike në nivele kombëtare dhe lokale, të ndërtojmë fuqitë dhe kapacitetet organizative të federatave kombëtare të sportit”.



Krasniqi shtoi se në mandatin e tij ai do të përpiqet që si Komitet Olimpik i Kosovës të ndërtohen kapacitete për të organizuar ngjarje të mëdha ndërkombëtare sportive. Të përfshihen specialistët nga Kosova në organet ndërkombëtare të qeverisjes së sportit, ndërsa prioritet do të mbeten edhe ndërtimi i kapaciteteve për lobim sportiv, rritja financiare, e krijimi i trashëgimisë infrastrukturore dhe jo infrastrukturore.



Duke folur për përfaqësimin e Kosovës në Lojërat Olimpike në Tokio, Krasniqi konfirmoi se krahas pesë xhudistëve që tashmë kanë siguruar normën olimpike për pjesëmarrje në këtë ngjarje globale sportive, tashmë të konfirmuar janë edhe dy notues dhe një atlet, ndërsa po punohet edhe në mbështetjen e sportistëve në disiplina të tjera, si në karate, skijim, etj..

“Ne do t’i mbështesim fuqishëm ata dhe t’i ndihmojmë në mënyrën më të mirë për përgatitjen e tyre që të mund të kualifikohen, sepse kemi garues potencial”, theksoi Krasniqi.

NDI NDAU MIRËNJOHJE PËR STUDENTËT E AAB-SË

12 Prill 2021



Studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike, Ermir Shabani dhe Arbëresha Aliçkaj, sot u nderuan me mirënjohje nga NDI (National Democratic Institute) për kontributin e dhënë në kuadër të Javës së Gruas 2020.



Në ceremoninë e ndarjes së mirënjohjeve, Pajtim Gashi nga NDI falënderoi Kolegjin AAB dhe në veçanti Fakultetin e Shkencave Kompjuterike për bashkëpunimin tashmë disa vjeçar në përkrahje të projektit “Java e Gruas” (Week of Women) që organizohet për të disatën herë me radhë.

Nga ana tjetër, studentët Ermir Shabani dhe Arbëresha Aliçkaj shprehën falënderimin e tyre për mirënjohjet e ndara për ta dhe njëkohësisht u shprehën të lumtur për pjesëmarrjen në këtë projekt dhe mundësinë për të dhënë kontributin e tyre profesional.


Emiri dhe Arbëresha ishin pjesë e ekipit të studentëve në krijimin dhe mirëmbajtjen e webfaqes së “Javës së Gruas 2020”, aktivitet ky ndërkombëtar ku morën pjesë edhe figura eminente nga mbarë bota, në mesin e tyre edhe ish Sekretarja Amerikane e Shtetit, Madeleine K. Albright.

PROF. ARIANIT MARAJ LIGJËROI PËR STUDENTËT E UNIVERSITETIT SMK TË LITUANISË

16 Prill 2021

Në kuadër të programit Erasmus+ Programme për mobilitetin e stafit akademik, prof. Arianit Maraj i cili është pjesë e stafit akademik në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike në AAB, ishte pjesë e shkëmbimit akademik në Universitetin SMK, me seli në Vilnius të Lituanisë.

Prof. Maraj, zhvilloi një ligjëratë për studentët e vitit të dytë të Programit Multimedia, Lojëra Kompjuterike dhe Animacion, me



temën: Edukimi për Sigurinë Kibernetike në vendet në zhvillim. Ai e vlerësoi si një përvojë shumë të mirë këtë shkëmbim, ndërsa falënderoi Kolegjin AAB për përkrahjen e vazhdueshme ndaj stafit akademik në ngritjen profesionale dhe akademike të tyre. AAB do të vazhdojë me aktivitete të këtilla ndërkombëtare, për stafin akademik por edhe për studentët, në kuadër të programeve të tilla për shkëmbim.

TRI STUDENTE FITUESE TË ÇMIMIT “MASAR STAVILECI” I CILI U NDA SOT NË DITËN BOTËRORE TË LIBRIT

23 Prill 2021

Në shënim të 23 Prillit, Ditës Botërore të Librit, në Kolegjin AAB u mbajt ceremonia e ndarjes së Çmimit “Masar Stavileci”. Ky çmim i themeluar nga Kolegji AAB, për çdo vit u ndahet studentëve të cilët kanë qenë lexuesit më aktivë në Bibliotekën Universitare AAB.

Çmimi “Masar Stavileci” i themeluar në vitin 2018, në nderim të rektorit të parë të Kolegjit AAB, prof.dr. Masar Stavileci, këtë vit u nda për të tretën herë.



Laureatë të sivjetmë të këtij çmimi janë tre studente: Dafina Buzoku, Florentina Peci dhe Vanesa Dubovci.

Në ceremoninë e ndarjes së çmimit, rektori i Kolegjit AAB, Bujar Demjaha përgëzoi fitueset e çmimit dhe tha se biblioteka është vendi më i rëndësishëm i Kolegjit, andaj ne kemi investuar dhe nuk do të ndalemi me investime. “Studentët janë ata të cilët i japin edhe më shumë rëndësi bibliotekës sonë”, tha Demjaha.

Nga ana tjetër, fitueset e çmimit u falënderuan për vlerësimin dhe premtuan se do të përpiqen t’i nxisin edhe kolegët e tjerë që sa më shumë të jenë pranë librit dhe në bibliotekë.



MBYLLI PUNIMET KONFERENCA SHKENCORE “PERSPEKTIVA E INTEGRIMIT TË BALLKANIT PERËNDIMOR NË BE”

24 Prill 2021

Nën organizimin e Kolegjit AAB, në bashkëpunim me universitete partnere nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut e Kroacia, të premtën dhe të shtunën zhvilloi punimet Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “Perspektiva e integritimit të Ballkanit Perëndimor në BE”.

Kjo konferencë e cila për shkak të situatës pandemike në mbarë globin u zhvillua virtualisht, mbledhi rreth vetes rreth 100 studiues nga vende të ndryshme, duke përfshirë Kosovën, Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Kroacinë, ShBA-të, Australinë, Belgjikën e Bullgarinë.





Kjo konferencë solli edhe tre personalitete të rëndësishme të shkencës në cilësinë e folësve kryesorë: Prof. Dr. Florian Bieber, nga Universiteti i Gracit (Austri), Prof. Assoc. Dr. Besnik Pula nga Virgina Tech (ShBA) dhe Prof. Dr. Anton Panchev nga Universiteti i Sofjes (Bullgari), ligjëratat e të cilëve u ndoqën me interesim të madh nga pjesëmarrësit.

Krahas tri ligjëratave speciale, punimet e konferencës u zhvilluan në tetë sesione të ndara ku u diskutuan tema nga integriteti, administrata, sundimi i ligjit, ekonomia, etj..



Punimet e pjesëmarrësve të konferencës “Perspektiva e integritetit të Ballkanit Perëndimor në BE”, do të publikohen në Librin e punimeve të konferencës (Book of Abstracts), ndërsa punimet më të mira do të publikohen edhe në një numër special të Revistës Shkencore “Thesis”.



AMBASADORI ÇAĞRI SAKAR, MBAJTI LIGJËRATË PËR POLITIKËN E JASHTME TË TURQISË

24 Prill 2021

Në kuadër të ligjëratave speciale me diplomatë të huaj, në Kolegjin AAB, për një ligjëratë me studentët e Fakultetit të Administratës Publike qëndroi ambasadori i Republikës së Turqisë, Çağrı Sakar.

Në ligjëratën për Politikën e jashtme të Turqisë, ambasadori turk në vendin tonë foli për rolin e vendit që përfaqëson në rajon, kontinent e më gjerë. Ai tha se Turqia ka marrëdhënie bilaterale me shtetet e Ballkanit Perëndimorë dhe mban lidhje të mira me të gjithë prej tyre.



“Politika Ballkanike e Turqisë miraton një parim të iniciativës rajonale dhe gjithëpërfshirëse”, tha Sakar duke nënvizuar se Kosova nuk ishte e përfshirë në iniciativa rajonale, ndërkohë që Turqia synon përfshirjen e secilit në Ballkan për të pasur sukses dhe bashkëpunim të vërtetë. Ai gjithashtu theksoi se Turqia përkrah dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Ambasadori i Turqisë në Kosovë, Çağrı Sakar foli edhe për zhvillimet e fundit diplomatike, lidhur me hapjen e Ambasadës së Republikës së Kosovës në Jerusalem, për çfarë tha se Turqia nuk pajtohet me një vendim të tillë, madje e ka cilësuar si një veprim i rrezikshëm. Sipas Sakar, Kosova me këtë vendim ka thyer ligjet ndërkombëtare.

Ligjëratat e diplomatit turk për studentë vazhdoi edhe me një seancë diskutimi ky studentët patën mundësi të marrin përgjigjet e tyre në pyetjet e shtrura për të ftuarin special.



SANA KLINIKEN AG NË GJERMANI PUNËSON STUDENTIN E PARË NGA KOSOVA, I DIPLOMUAR NË KOLEGJIN AAB

29 Prill 2021



Në kuadër të bashkëpunimit të Kolegjit AAB me të Sana Kliniken AG në Gjermani, javën e kaluar filloi punën infermieri i parë në Sana.

Kushtrim Haliti, i cili ka mbaruar me sukses studimet e Infermierisë në Kolegjin AAB, tani po e realizon fazën e nevojshme të punës praktike në spitalin Sana Hürth për njohjen formale si punonjës profesional i infermierisë.

Kushtrim Haliti qysh më herët ka pasur ambicie të shkojë në Gjermani, të jetojë dhe punojë në fushën e mjekësisë. Ai arriti ta realizojë ëndrrën përmes bashkëpunimit të Kolegjit AAB dhe Sana Kliniken AG.

“Jam pritur këtu në mënyrë të përzemërt dhe po ndihem shumë mirë”, tha Kushtrimi i cili tashmë ka përfunduar javën e parë të punës si asistent infermier.

Punësimi i Kushtrimit në Klinikën Sana në Gjermani, është mundësuar përmes Programit për Karrierë dhe Punësim, i cili është program unik që funksionon në kuadër të Fakultetit të Infermierisë në Kolegjin AAB. Ditëve në vazhdim pritet të bëhen pjesë e stafit të këtij rrjeti të njohur spitalor edhe studentë të tjerë, të cilët tashmë kanë nënshkruar kontratat e punësimit.

Artikel

Erster Student aus dem Kosovo startete im Sana-Krankenhaus Hürth

Im Rahmen des Kooperationsprogramms zwischen der Sana Kliniken AG und dem AAB College Pristina, in der Republik Kosovo, startete vergangene Woche der erste Mitarbeiter bei Sana: Kushtrim Haliti schloss im Kosovo sein Krankenpflegestudium erfolgreich ab und wird nun am Sana-Krankenhaus Hürth die notwendigen Praxisstunden für die Anerkennung zum examinierten Pflegefachmann absolvieren.



STUDENTJA LIRIE HOTI KA FITUAR BURSËN E PLOTË PËR PROGRAMIN E LIDERËVE TË INOVACIONIT QË DO TË MBAHET NË UNIVERSITETIN E LUND NË SUEDI

29 Prill 2021



Pjesëmarrëse në disa gara ndërkombëtare, si ajo për ndërmjetësim e mbajtur në Lituani, apo gara tjetër e studentëve e mbajtur në Universitetin e Harvardit, studentja e Kolegjit AAB, Lirie Hoti, ka arritur edhe një sukses tjetër.

Ajo ka arritur të fitojë bursën e plotë për Programin e Liderëve të Inovacionit, të cilën e ndan Instituti Suedez (Swedish Institute) e që do të mbahet në Universitetin e Lund në Suedi.

“Pas kalimit me sukses të të gjitha fazave të vlerësimit, sot ndjehem krenare dhe shumë e lumtur ta ndaj lajmin me ju se jam përfituese e bursës së plotë nga Suedish Institute (Instituti Suedez) dhe të jem në mesin e 30 studentëve të përzgjedhur nga shtetet e Ballkanit

Perëndimor për të marrë pjesë në modulin i cili do të mbahet në Universitetin Lund të Suedisë”, ka thënë Liria.

Qëllimi i Liderëve të Inovacionit të SI (SIIL) është të kontribuojë në ekosistemin e inovacionit në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Qëllimi është të krijohet një platformë për shkëmbimin e njohurive dhe zgjidhjen e problemeve midis ekspertëve të fushës së inovacionit brenda sektorit privat, sektorit publik dhe akademisë, me ndihmën e ekspertizës dhe përvojës suedeze.

Lirie Hoti është studente absolvente në Fakultetin Juridik me rezultate maksimale në studime, ndërsa me rezultat të tillë ka përfunduar edhe studimet në Fakultetin e Gjuhës Angleze në Kolegjin AAB.

REKTORI DEMJAHA NËNSHKROI DOKUMENTIN E RI TË MAGNA CHARTA UNIVERSITATUM MCU2020

29 Prill 2021

Rektori i Kolegjit AAB, Dr.sc. Bujar Demjaha, nënshkroi dokumentin e ri të Magna Charta Universitatum, MCU2020, i cili do të hyjë në fuqi në qershor të vitit 2021.



Ky dokument i ri i MCU përfshin të gjitha vlerat themelore origjinale të dokumentit themeltar të Magna Charta, ndërsa përpiqet të rezonojë edhe mbi sfidat dhe shqetësimet bashkëkohore.

Nënshkrimi i Magna Charta Universitatum është dëshmi e faktit se Kolegji AAB është një anëtar i komunitetit global të arsimit të lartë të përkushtuar për përsosmëri akademike dhe ofrim të cilësisë së lartë në arsim. Ndryshe, Kolegji AAB është nënshkrues i Magna Charta Universitatum që nga viti 2010, ndërsa është i vetmi institucion jopublik i arsimit të lartë në vend, që është anëtar i kësaj organizate të rëndësishme akademike.

Magna Charta Universitatum u hartua në vitin 1988 nga rektorë të universiteteve evropiane fillimisht u nënshkrua nga 388 universitete, ndërsa sot numëron mbi 900 institucione të Arsimit të Lartë në të gjithë botën dhe është referimi kryesor i cili mbështet parimet themelore të arsimit të lartë me një fokus të veçantë mbi parimet e lirisë akademike dhe autonomisë institucionale të përcaktuara në këtë dokument.

SHËNOHET DITA NDËRKOMBËTARE E JAZZ NGA STUDENTËT E FAKULTETIT TË ARTEVE

30 Prill 2021

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Jazz-it, studentët e Fakultetit të Arteve të Kolegjit AAB zhvilluan një sërë aktivitete.

Rektori i Kolegjit AAB në hapje të këtij manifestimi përgëzoi organizatorët, Fakultetin e Arteve, dhe uroi që kjo ngjarje të shënohet në vazhdimësi: “Shpresoj që ky aktivitet të vazhdojë edhe më tutje në vitet tjera dhe të jetë edhe më i “gjallë” kur do të hiqen kufizimet nga pandemia”.



Përmes një video mesazhi studentëve iu drejtua edhe jazz kitaristi i njohur shqiptar, Faton Macula, i cili jeton dhe vepron në ShBA. Ai porositi studentët dhe institucionet e artit e kulturës që t’i kushtojnë rëndësi edhe më tej kësaj dite dhe kësaj rryme muzikore, ndërsa studentëve u premtoi se së shpejti do t’u ofrojë edhe punëtori për jazz-in dhe teorinë e jazz. Sipas Maculës, Jazz është niveli më i lartë i muzikës, dhe se kjo formë muzikore nuk është vetëm zhanër por është mënyrë jetese (lifestyle).



Në shënim të kësaj dite, studentët e drejtimit të Muzikologjisë, Gent Malazogu dhe Arta Elezi, sollën performanca artistike me interpretimet e tyre jazz.

Me po të njëjtën tematikë u hap edhe Ekspozita e studentëve të Fakultetit të Dizajnit Grafik dhe Multimedias, që kompletoi edhe më shumë aktivitetin e sotëm.





info@aab-edu.net

+383 38 600 005

+383 (0) 45 284 797  

Rr. Elez Berisha, Nr.56
10000 Prishtinë Republika e Kosovës

